

MARCOTHERM PRIMER

ASTAR MURI I HOLLUESHËM, MBULUES PËR BRENDA DHE JASHTË

SERIE 474

PËRSHKRIMI

MARCOTHERM PRIMER është astar I hollueshëm me penetrim të lartë, I përshtatshëm për ngopjen dhe konsolidimin e sipërfaqeve minerale të brendshme dhe të jashtme. Astar mbulues specifik për sistemin Cappotto MARCOTHERM.

Produkti evidenton praninë e mundshme të lagështirës në nivele të larta në pjesët e mbetura pambuluar.

Formular me polimere të pajisura me grimca MARCOTHERM PRIMER, në prani të sipërfaqeve jo-homogjene, stuko, copa, uniformon sipërfaqen duke krijuar vendosjen ideale për shtresat pasuese.

MARCOTHERM PRIMER është i përshtatshëm si themel për shtresat e trasha, ngjyra dhe dekorime me natyrë minerale ose sintetike.

MARCOTHERM PRIMER, i ngjyrosur në mënyrë të përshtatshme me tintometër, lejon mbulim të shkëlqyer në ciklet e lyerjes me tonalitete intensive dhe të ndritshme.

INSTRUKSIONE PËR PËRDORIM

I aplikueshëm në:

-Sisteme termike cappotto Marcotherm.

-Suvatime të reja e të vjetra me lidhës hidraulike.

-Sipërfaqe betoni..

-Sipërfaqe gipsi dhe kartonxhesi.

Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale, të thara, kompakte, absorbuese dhe kohezive.

-Konglomerate me natyrë të ndryshme minerale absorbuese.

-Sipërfaqe dekorative me trashësi (Grassello di calce, Marmorino classico, Stucco veneziano) në prani të sipërfaqeve jo-homogjene, stukove për unifromimin e absorbimit të sipërfaqes.

Sipërfaqet përgatiten sipas shpjegimit në paragrafin "Përgatitja e sipërfaqes".

Mos aplikoni në sipërfaqe të freskëta.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

-Natyra e kordonit: Mikroemulsione me pak erë.

-Tretësi: Uji.

-Dendësia: UNI EN ISO 2811-1: 1,18-1,24 kg/l

-Tharja (25 °C dhe 65% di U.R.): kontakt pas 30-40 min; shtresa tjetër pas 2 orësh.

PËRGATITJA E SIPERFAQES

Sipërfaqet në suva, xhes dhe kartonxhes:

-Sigurohuni që sipërfaqja të ketë një kohë maturimi prej të paktën 28 ditësh.

-Kontrolloni gjendjen e ruajtjes. Sipërfaqja duhet të jetë konsistente. Në të kundërt siguroni konsolidim me produkte specifike.

-Në prani të mykut trajtojeni sipërfaqjen me detergjentin COMBAT 222 cod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).

-Hiqni duke zmeriluar ose me larje ndotjet prezente.

-Në prani të bojërave të vjetra largoni pjesët e pluhurosura dhe jo mirë të aderuar, ndërkohë që shtresa me bojë gëlqere dhe tempera (bojë traspirante) duhet të hiqen totalisht duke larë me ujë të bollshëm sipërfaqen.

-Nivloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni vrimat, çarjet në sipërfaqe me TAMSTUCCO 9400006 ose TAMSTUCCO POLVERE 9410110 ose STUCCOFACILE 9560019.

-Mbyllni çarjet me ngjitës (stuko) të përshtatshëm.

-Kryeni zbutje në sipërfaqe me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose me RASOMARC 9500150 në bazë të llojit të sipërfaqes.

-Hiqni pluhurin, smogun dhe te tjera me letër zmerile.

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe aplikoni MARCOTHERM PRIMER sipas instruksioneve për aplikim.

-Pas të paktën 2 orësh vazhdoni me aplikimin e produktit përfundimtar.

Sipërfaqe betoni:

MARCOTHERM PRIMER

ASTAR MURI I HOLLUESHËM, MBULUES PËR BRENDA DHE JASHTË

SERIE 474

-Zmeriloni sipërfaqen dhe eliminoni shtresat e dëmtuara të bojës së vjetër.

-Në prani të mykut trajtoni sipërfaqjen me detergjentin COMBAT 222 cod. 4810222 dhe me restauruesin COMBAT 333 cod. 4810333.

-Hiqni pjesët e dëmtuara/ jo mirë të aderuara të cimentos.

-Shufrat metalike të armaturës në sipërfaqe duhet të lyhen me BETOXAN PRIMER 9490125 Boiaccia passivante.

-Rivendosni pjesët që mungojnë me zbutësin BETOXAN 400 ose BETOXAN 300 llaç tiksotropik anti-tkurrije me fibra të përforuara 9490140/130; kryeni ngjitjen përfundimtare me anti-karbonatizuesin anti-tkurrije BETOXAN 200 9.490.120.

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë dhe të aplikohet një shtresë astar ISOMARC me bazë tretës 4410111 ose ATOMO I mikronizuar pa tretës 8840001. Për sipërfaqje të qëndrueshme, jo me pluhur, aplikoni astar me baze uji MARCOTHERM PRIMER 4.740.019.

-Pas të paktën 2 orësh vazhdoni me aplikimin e produktit përfundimtar.

UDHËZIME PËR APLIKIM

Kushtet e mjedisit dhe të sipërfaqes:

-Temperatura e mjedisit : Min. +8 °C / Max. +35 °C

-Lagështira relative e mjedisit: <75%

-Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C

-Lagështira e sipërfaqes: <10%

-Shmangni aplikimet në prani të sipërfaqeve me kondensim ose nën veprimin e drejtpërdrejtë të diellit.

-Mjetet: penel, rrul.

-Nr.i shtresave: aplikohen 1-2 shtresa në sipërfaqje të fresket.

-Hollimi: Marcotherm Primer hollohet nga 20-30% me ujë në bazë të absorbimit të sipërfaqjes.

-Mjetet duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me ujë.

-Shkalla e përhapjes: 8-10 m²/lt. Këshillohet të bëhet një provë paraprake për të caktuar konsumin.

NGJYROSJA

Ngjyrosja mund të arrihet përmes sistemit tintometrik Marcromie. Produkti gjithashtu mund të ngjyroset me kolorantet COLORADO seri 548, deri në maksimumi 5%.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30° C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 ° C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh original të papapurr dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)

Cat. A/h: astar fiksues (bazë uji): 30 g/l
(2010) MARCOTHERM PRIMER përmban max: 30 g/l VOC

I dëmshëm për organizmat ujorë, mund të shkaktojë në periudhë afatgjatë efekte negative në mjedisin ujor.

Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe ruhet sipas rregullave aktuale të shëndetit dhe sigurisë; I thani mbetjet tërësisht dhe trajtoni ato si mbeturina të veçanta. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Astar muri për brenda/jashtë.

Aplikimi, në sipërfaqe të parapërgatitura për astarin mural MARCOTHERM PRIMER kod. 4740019, me bazë mikroemulsione të përshtatshëm për ngopjen e sipërfaqes murale në sasinë e duhur, në bazë të absorbimit.

Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike

MARCOTHERM PRIMER

ASTAR MURI I HOLLUESHËM, MBULUES PËR BRENDA DHE JASHTË
SERIE 474

*dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë
asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke
qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit
të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë
efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anulon
dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për
informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në
nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.*

Eraldi Shpk